



Pranuar / Dorezuar Prilimni/Prodato Received/Deliverty	04.12.2020	0	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prist Nr Prist Prisr No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPINSHOK	2971/2020		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.319/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokoll 2244/2020 të datës 26.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi Rr "Kumanovës" nr. 19 Gjilan, kundër organit të punësimit-Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.12.2020, mori këtë.

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër protokoll 2244/2020 e datës 26.10.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].
- II.Shfuqizohet Vërejtja e shqiptuar nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës e datës 07.10.2020 me numër protokoll 195/2020.
- III. Obligohet Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij
- IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- V.Vendimi hyn në fuqi ne ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Kolegjit.

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [REDACTED], Drejtorë i Qendrës së Situatave sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt emërimit të datës 05.02.2020 me Nr. protokoll 40/2020, më datën 07.10.2020, Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës i shqiptohet vërejtje me arsyetimin se janë bërë gabime në raportin e datës 06.10.2020.




Ankuesi, në ankesën e tij pretendon se masa disiplinore e shqiptuar nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale.

Ankuesi i pakënaqur me shqiptimin e vërejtjes nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në afatin ligjor, me datën 26.10.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2244/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 02.11.2020 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Këshilli i Sigurisë së Kosovës. Me datën 11.11.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës përmes e- mailit zyrtar.

**Administrimi i provave-**Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa me numër protokolli 2244/2020 e datës 26.10.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Vërejtje e datës 07.10.2020 me numër protokolli 195/2020, Raporti mbi gjendjen e sigurisë në Kosovë me numër protokolli 259 e datës 05.10.2020, Raporti mbi gjendjen e sigurisë në Kosovë me numër protokolli 260 e datës 06.10.2020, Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 05.02.2020 me numër protokolli 40/2020, Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.02.2020, dhe Përgjigje në ankesë e datës 11.11.2020 nga organi i punësimit me numër protokolli 2549/2020 përmes e-mailit zyrtar të datës 11.11.2020.

Andaj në mënyrë kronologjike Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit  është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se vërejtja e shqiptuar nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë me datën 07.10.2020, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se vërejtja e shqiptuar me datën 07.10.2020 me numër protokolli 195 nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e nenit 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili qartë sqaron se *“shkeljet e lehta konsiderohen...4.1.mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy(2) ditë pune , 4.2.shkelja e rregullave të etikës, 4.3. sjellja e parregullt gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun, 4.4.kryerja e veprimeve,”* dhe nenit 50 paragrafi 1 ku përcaktohet se *„Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ose komisioni disiplinor bazohet në.1.1. shkaqe, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj”.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendim tjetër ankimor i ankuesit është se Sekretari në vërejtjen e shqiptuar si shkelje konstaton se raporti i datës 06.10.2020 është kopjuar nga raporti i datës 05.10.2020 nga IKSHPK, është i qëndrueshëm sepse raporti i datës 06.10.2020 përmban të dhënat e sakta për numrin e përgjithshëm të të infektuarve, numrin e përgjithshëm të të shëruarve, të dhënat e sakta për numrin e përgjithshëm të të vdekurve si dhe përmban të dhënat e sakta për numrin e përgjithshëm të rasteve aktive me virusin Covid 19, ajo që



është bërë gabim në këtë raport janë të dhënat për testet e bëra gjatë 24 orëve, numri i të infektuarve , numri i të shëruarve dhe numri i të vdekurve nga Covid 19, shifra e të cilëve është e njëjtë me raportin e datës 05.10.2020 dhe në këtë rast nuk mund të vërtetohet se kemi të bëjmë me një kopje të raportit sepse raportet e datës 05.10.2020 dhe 06.10.2020 kanë dallime përmbajtësore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se në vërejtjen e shqiptuar me datën 07.10.2020 me numër protokoll 195 nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës thuhet se përveç gabimit të bërë në raportin e datës 06.10.2020 edhe më parë z. [REDAKTUAR] i është tërhequr vërejtje gojarisht, e për këtë kemi kërkuar nga organi i punësimit se a ka dëshmi që ankuesit i është tërhequr vërejtje me gojë, por nuk kanë ofruar asnjë dëshmi përkundër që e kanë potencuar në vërejtjen e datës 07.10.2020 me numër protokoll 195, andaj Kolegji vlerëson se Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës nuk ka arritur të argumentojë se veprimi i ankuesit bie ndesh me dispozitat e nenit 46, paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar se Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës me rastin e shqiptimit të vërejtjes të datës 07.10.2020 me numër protokoll 195 ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sepse nuk ka vërtetuar në asnjë mënyrë dhe formë se ankuesi ka bërë shkelje të lehtë disiplinore.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

#### Vendimi i dërgohet

- Ankuesit, [REDAKTUAR]
- Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillin e Sigurisë së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A nr.319/2020, datë 04/12/2020

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*

Procesmbajtëse

